

VENDIM
Nr.1160, datë 25.11.2009

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.984, DATË 30.9.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR CIKLIN E DYTË TË
STUDIMEVE DHE “MASTER I NIVELIT TË PARË”, ME KOHË TË PLOTË, PËR
VITIN AKADEMIK 2009-2010”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.984, datë 30.9.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

a) Në shkronjën “b” të tabelës nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, pas numrit V shtohet numri VI, me këtë përmbajtje:

“VI. Në Fakultetin e Inxhinierisë
Matematike dhe Inxhinierisë Fizike 56 000 lekë.”.

b) Në shkronjën “b”, të tabelës nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi, pas numrit V shtohet numri VI, me këtë përmbajtje:

“VI. Në Fakultetin e Inxhinierisë
Matematike dhe Inxhinierisë Fizike 70 000 lekë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha